



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2463 / Prot.
1

Tiranë, më 3.7. 2020

URDHËR

Nr. 249, Datë 3.7.2020

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË "DREJTËSI" NË UNIVERSITETIN "NEW YORK", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Drejtësi", që realizohet me 300 kredite dhe kohëzgjatje normale 5 vite akademike (10 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e integruar e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", të riorganizuar, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut, Tiranë të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti i New York-ut, Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI

